



Universiteti Politeknik i Tiranës
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Departamenti i Konstruksioneve
dhe Infrastrukturës së Transporteve

Tema e disertacionit:

**Studim për përcaktimin e karakteristikave
të deformkohës dhe tkurrjeve
në betonet e prodhuara me Hira Teci - Kosovë**

Udhëheqësi i punimit:

Prof. asoc. Dr. Fisnik Kadiu

Kandidati:

Lulëzim Bytyçi

Tiranë, 2016

Përmbajtja

Lista e fotove /vi

Lista e figurave /vii

Lista e tabelave /xi

Parathënie /14

Kapitulli 1

1 Hyrje /17

Kapitulli 2

2. Njohuritë nga literatura /25

I.2 Disa të dhëna mbi deformimet në beton në funksion të kohës
(deformkoha dhe tkurrjet) /25

I.2.1 Të përgjithshme /25

I.2.2 Moduli i Elasticitetit /26

I.2.3 Deformkoha dhe tkurrja në beton /27

I.2.3.1 Faktorët që ndikojnë në deformkohë dhe tkurje /27

I.2.3.2 Tkurrja e betonit /28

I.2.3.2.1 Tkurrja gjatë tharjes /28

I.2.3.2.2 Tkurrja plastike /29

I.2.3.2.3 Faktorët e brendshëm /29

I.2.3.2.4 Faktorët e jashtëm /31

I.2.3.3 Deformkoha në beton /32

I.2.3.3.1 Ndikimi nga faktorët e brendshëm në deformkohë /34

I.2.3.3.2 Ndikimi nga faktorët e jashtëm në deformkohë /35

II.2 Kriteret për llogaritje, sipas EC-2; ACI-209 dhe CEB-FIP /37

II.2.1 Moduli i Elasticitetit /37

II.2.1.1 Moduli i Elasticitetit, sipas EC2 /37

II.2.1.2 Moduli i Elasticitetit, sipas ACI-209 /38

II.2.1.3 Moduli i Elasticitetit, sipas CEB-FIP /39

II.2.2 Deformkoha dhe tkurrja /40

II.2.2.1 Deformkoha dhe tkurrja, sipas EC 2 /40

II.2.2.1.1 Deformkoha e betonit /40

II.2.2.1.2 Tkurrja e betonit /42

II.2.2.2 Deformkoha dhe tkurrja, sipas ACI	/42
II.2.2.2.1 Deformkoha e betonit	/42
II.2.2.2.2 Tkurrja e betonit	/43
II.2.2.3 Deformkoha dhe tkurrja, sipas CEB-FIP	/44
II.2.2.3.1 Deformkoha e betonit	/44
II.2.2.3.2 Tkurrja e betonit	/44
II.2.3 Hiri fluturues	/45

Kapitulli 3

3. Hulumtimet laboratorike	/47
3.1 Përshkrimi i programit eksperimental	/47
3.2 Materialet për punimin e mostrave	/48
3.3 Receptura - Mix Design e betonit	/49
3.3.1 Çimento	/49
3.3.2 Hiri i Tecit	/51
3.3.3 Receptura për Mix 1 (C 25/30 Etalon)	/52
3.3.4 Receptura për Mix 2 (C 25/30 me 25% Hira Tecit)	/53
3.3.5 Receptura për Mix 3 (C 30/37 Etalon)	/54
3.3.6 Receptura për Mix 4 (C 30/37 me 25% Hira Tecit)	/55
3.3.7 Receptura për Mix 5 (C 40/50 Etalon)	/56
3.3.8 Receptura për Mix 6 (C 40/50 me 25% Hira Tecit)	/57
3.4 Përgatitja e recepturave (Mix-eve)	/58
3.4.1 Disa foto gjatë përgatitjes së Mix-eve	/58
3.4.2 Përzierja Mix 1	/61
3.4.3 Përzierja Mix 2	/62
3.4.4 Përzierja Mix 3	/63
3.4.5 Përzierja Mix 4	/64
3.4.6 Përzierja Mix 5	/65
3.4.7 Përzierja Mix 6	/66
3.5 Pajisjet për matje	/67
3.6 Ekzaminimi i mostrave dhe mënyra e ngarkimit	/67
3.6.1 Soliditeti në shtypje	/67
3.6.2 Soliditeti në tërheqje me çarje	/68
3.6.3 Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë	/68
3.6.4 Soliditeti në tërheqje me lakim	/9
3.6.5 Moduli i Elasticitetit	/69

- 3.6.6 Matja e tkurrjeve /70
- 3.6.7 Deformimet nga deformkoha /71

Kapitulli 4

- 4. Përmbledhja e rezultateve /73
 - 4.1 Karakteristikat mekanike /73
 - 4.1.1 Soliditeti në shtypje i betonit të ngurtësuar /7
 - 4.1.1.1 Soliditeti në shtypje për Mix 1 /73
 - 4.1.1.2 Soliditeti në shtypje për Mix 2 /74
 - 4.1.1.3 Soliditeti në shtypje për Mix 3 /76
 - 4.1.1.4 Soliditeti në shtypje për Mix 4 /77
 - 4.1.1.5 Soliditeti në shtypje për Mix 5 /78
 - 4.1.1.6 Soliditeti në shtypje për Mix 6 /80
 - 4.1.2 Soliditeti në tërheqje me çarje i betonit të ngurtësuar /81
 - 4.1.2.1 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 1 /81
 - 4.1.2.2 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 2 /82
 - 4.1.2.3 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 3 /83
 - 4.1.2.4 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 4 /84
 - 4.1.2.5 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 5 /85
 - 4.1.2.6 Soliditeti në tërheqje me çarje për Mix 6 /86
 - 4.1.3 Soliditetin në tërheqje me lakim i betonit të ngurtësuar /87
 - 4.1.3.1 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 1 /88
 - 4.1.3.2 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 2 /89
 - 4.1.3.3 Soliditeti në tërheqje me lakim për Mix 3 /90
 - 4.1.3.4 Soliditeti në tërheqje me lakim për Mix 4 /91
 - 4.1.3.5 Soliditeti në tërheqje me lakim për Mix 5 /92
 - 4.1.3.6 Soliditeti në tërheqje me lakim për Mix 6 /93
 - 4.2 Ekzaminimi i ujë-përshkueshmërisë /94
 - 4.2.1 Ujë-përshkueshmëria për Mix 1 /94
 - 4.2.2 Ujë-përshkueshmëria për Mix 2 /95
 - 4.2.3 Ujë-përshkueshmëria për Mix 3 /96
 - 4.2.4 Ujë-përshkueshmëria për Mix 4 /97
 - 4.2.5 Ujë-përshkueshmëria për Mix 5 /98
 - 4.2.6 Ujë-përshkueshmëria për Mix 6 /99
 - 4.3 Përmbledhja e rezultateve nga deformkoha dhe tkurrja /100
 - 4.3.1 Rezultatet e deformimeve nga tkurrja /100

4.3.1.1	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 1	/102
4.3.1.2	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 2	/103
4.3.1.3	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 3	/104
4.3.1.4	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 4	/105
4.3.1.5	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 5	/106
4.3.1.6	Rezultatet e deformimeve nga tkurja për Mix 6	/107
4.3.2	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha	/108
4.3.2.1	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 1	/109
4.3.2.2	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 2	/111
4.3.2.3	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 3	/114
4.3.2.4	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 4	/116
4.3.2.5	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 5	/119
4.3.2.6	Rezultatet e deformimeve nga deformkoha për Mix 6	/121
4.3.4	Rezultatet e deformimeve totale për Mix 3 – Mix 2 – Mix 4 – Mix 6	/114
4.3.4.1	Rezultatet e deformimeve totale për Mix 3	/124
4.3.4.2	Rezultatet e deformimeve totale për Mix 2	/125
4.3.4.3	Rezultatet e deformimeve totale për Mix 4	/125
4.3.4.4	Rezultatet e deformimeve totale për Mix 6	/126

Kapitulli 5

5.	Diskutimi i rezultateve	/128
5.1	Soliditeti në shtypje	/129
5.2	Soliditeti në tërheqje me çarje	/139
5.3	Soliditeti në tërheqje me lakim	/147
5.4	Moduli i Elasticitetit	/149
5.5	Ujë-përshkueshmëria	/152
5.6	Deformimet në beton në funksion të kohës	/157
5.6.1	Deformimet nga tkurja	/161
5.6.2	Deformkoha	/165
5.6.3	Ndikimi i formës së mostrës në deformimet nga tkurja	/174
5.6.4	Deformimet totale për Mix 2- Mix 4 – Mix 6 – Mix 3	/179

Kapitulli 6

6.	Përmbledhje, konkluzione dhe rekomandime	/186
----	--	------

Kapitulli 7

7.	Referencat e shfrytëzuara	/191
----	---------------------------	------

Lista e fotove

Fragmente nga studimi laboratorik i përgatitjes së përzierjeve provë	/17
Hapësira për eksperiment	/18
Mbushja e kallëpeve për një Mix	/18
Vendosja në presë dhe aplikimi i forcës	/18
Ekzaminimi i soliditetit në shtypje	/19
Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje me çarje	/19
Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë	/19
Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje me lakim	/19
Ekzaminimi i modulit të elasticitetit	/19
Mekanizmi për matjen e deformimeve nga deformkoha	/20
Foto 3.1 a/Hapësira për eksperiment / deformkoha, b/Hapësira për eksperiment / tkurrja	/47
Foto 3.2 Çimento	/48
Foto 3.3 Agregati	/48
Foto 3.4 Hiri i Tecit	/48
Foto 3.5 Aditivi	/48
Foto 3.6 Termocentrali 'Kosova B'	/51
Foto 3.7 Deponimi i hirit	/51
Foto 3.8 Përzierësja horizontale	/58
Foto 3.9 Brumi i betonit	/58
Foto 3.10 Matja e temperaturës së betonit të njomë	/58
Foto 3.11 Matja e konsistencës	/59
Foto 3.12 Matja e poroziteti	/59
Foto 3.13 Ngjeshja e mostrave	/59
Foto 3.14 Mbushja e kallëpeve për një Mix	/59
Foto 3.15 Vendosja e reperëve për matjen e deformimeve	/60
Foto 3.16 Vendosja në pres dhe aplikimi i forcës	/60
Foto 3.17 Matja para dhe pas aplikimit të forcës	/60
Foto 3.18 Ekzaminimi i soliditetit në shtypje	/68
Foto 3.19 Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje me çarje	/68
Foto 3.20 Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë	/69
Foto 3.21 Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje me lakim	/69
Foto 3.22 Ekzaminimi i modulit të elasticitetit	/70
Foto 3.23 Mostrat për matje të tkurrjeve	/70
Foto 4.1 Vendosja e pikave matëse të tkurrjeve	/101
Foto 4.2-a, b Vendosja e mostrave për matje të deformimeve nga tkurrja	/101
Foto 4.3-a, b Vendosja e mostrave në presë për matje të deformimeve nga deformkoha	/108

Lista e figurave

Figura 2.1. Diagrami i raportit sforcim-deformim i betonit	/26
Figura 2.2. Tkurrja e betonit	/28
Figura 2.3. Lidhja ndërmjet pjesëmarrjes së ujit në betonin e njomë dhe tkurrjeve gjatë tharjes	/29
Figura 2.4. Ndikimi në tkurrje i raportit ujë/çimento dhe pjesëmarrja e agregatit	/30
Figura 2.5. Lidhja midis tkurrjes dhe kohës për betonet e ruajtura në lagështi relative të ndryshme	/31
Figura 2.6 Deformimet në beton në funksion të kohës	/33
Figura 2.7. Deformimet në beton nga aplikimi i ngarkesës dhe pas largimit të saj	/33
Figura 2.8. Deformkoha e betonit me përzierje të caktuar, me agregat të ndryshëm, ngarkuar në moshën 28 ditë dhe i ruajtur në temperaturë 21°C dhe lagështi relative 50%	/34
Figura 2.9. Koeficienti i deformkohës në varësi të faktorit ujë-çimento	/35
Figura 2.10. Ndikimi i lagështisë relative në koeficientin e deformkohës	/36
Figura 2.11. Efekti i temperaturës së betonit në deformkohë	/36
Figura 2.12. Diagrami i koeficientit të deformkohës në funksion të nivelit të ngarkesës	/37
Figura 3.1 Temperatura dhe lagështia relative e ambientit OLSKA ING	/47
Figura 3.2 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 1	/52
Figura 3.3 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 2	/53
Figura 3.4 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 3	/54
Figura 3.5 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 4	/55
Figura 3.6 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 5	/56
Figura 3.7 Lakoret granulometrike të agregatit për Mix 6	/57
Figura 3.8 Mekanizmi për caktimin e deformimeve të deformkohës në cilindra me dimensione d/h=100/200 [mm]	/71
Figura 4.1 Soliditeti në shtypje – Mix 1	/74
Figura 4.2 Soliditeti në shtypje - Mix 2	/75
Figura 4.3 Soliditeti në shtypje – Mix 3	/77
Figura 4.4 Soliditeti në shtypje – Mix 4	/78
Figura 4.5 Soliditeti në shtypje – Mix 5	/79
Figura 4.6 Soliditeti në shtypje – Mix 6	/81
Figura 4.7 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 1) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/82
Figura 4.8 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 2) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/83
Figura 4.9 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 3) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/84
Figura 4.10 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 4) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/85
Figura 4.11 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 5) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/86
Figura 4.12 Soliditeti në tërheqje me çarje (Mix 6) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/87
Figura 4.13 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 1) në vjetërsinë >28 ditë	/88
Figura 4.14 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 2) në vjetërsinë >28 ditë	/89
Figura 4.15 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 3) në vjetërsinë >28 ditë	/90
Figura 4.16 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 4) në vjetërsinë >28 ditë	/91
Figura 4.17 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 5) në vjetërsinë >28 ditë	/92
Figura 4.18 Soliditeti në tërheqje me lakim (Mix 6) në vjetërsinë >28 ditë	/93
Figura 4.19 Ujë-përshkueshmëria (Mix 1) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/94
Figura 4.20 Ujë-përshkueshmëria (Mix 2) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/95
Figura 4.21 Ujë-përshkueshmëria (Mix 3) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/96

Figura 4.22 Ujë-përshkueshmëria (Mix 4) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/97
Figura 4.23 Ujë-përshkueshmëria (Mix 5) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/98
Figura 4.24 Ujë-përshkueshmëria (Mix 6) në vjetërsinë 28 dhe 90 ditë	/99
Figura 4.25 Pozita e vendosjes së pikave për matje e tkurrjeve me deformetër	/101
Figura 4.25 Deformimet nga tkurrja - Mix 1	/102
Figura 4.26 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 1	/102
Figura 4.27 Deformimet nga tkurrja - Mix 2	/103
Figura 4.28 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 2	/103
Figura 4.29 Deformimet nga tkurrja Mix – 3	/104
Figura 4.30 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 3	/104
Figura 4.31 Deformimet nga tkurrja - Mix 4	/105
Figura 4.32 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 4	/105
Figura 4.33 Deformimet nga tkurrja - Mix 5	/106
Figura 4.34 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 5	/106
Figura 4.35 Deformimet nga tkurrja - Mix 6	/107
Figura 4.36 Deformimet nga tkurrja dhe lagështia relative - Mix 6	/107
Figura 4.37 Deformimet totale - Mix 1	/109
Figura 4.38 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 1	/109
Figura 4.39 Deformimet nga deformkoha dhe tkurrjet - Mix 1	/110
Figura 4.40 Deformimet nga deformkoha - Mix 1	/110
Figura 4.41 Koeficienti i deformkohës - Mix 1	/111
Figura 4.42 Deformimet totale - Mix 2	/111
Figura 4.43 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 2	/112
Figura 4.44 Deformimet nga deformkoha dhe tkurrja - Mix 2	/112
Figura 4.45 Deformimet nga deformkoha - Mix 2	/113
Figura 4.46 Koeficienti i deformkohës - Mix 2	/113
Figura 4.47 Deformimet totale - Mix 3	/114
Figura 4.48 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 3	/114
Figura 4.49 Deformimet deformkoha dhe tkurrjet - Mix 3	/115
Figura 4.50 Deformimet nga deformkoha - Mix 3	/115
Figura 4.51 Koeficienti i deformkohës - Mix 3	/116
Figura 4.52 Deformimet totale - Mix 4	/116
Figura 4.53 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 4	/117
Figura 4.54 Deformimet deformkoha dhe tkurrjet - Mix 4	/117
Figura 4.55 Deformimet nga deformkoha - Mix 4	/118
Figura 4.56 Koeficienti i deformkohës - Mix 4	/118
Figura 4.57 Deformimet totale - Mix 5	/119
Figura 4.58 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 5	/119
Figura 4.59 Deformimet nga deformkoha dhe tkurrja - Mix 5	/120
Figura 4.60 Deformimet nga deformkoha - Mix 5	/120
Figura 4.61 Koeficienti i deformkohës - Mix 5	/121
Figura 4.62 Deformimet totale - Mix 6	/121
Figura 4.63 Deformimet dhe lagështia relative - Mix 6	/122
Figura 4.64 Deformimet nga deformkoha totale dhe tkurrjet - Mix 6	/122
Figura 4.65 Deformimet nga deformkoha - Mix 6	/123
Figura 4.66 Koeficienti i deformkohës - Mix 6	/123
Figura 4.67 Deformimet totale - Mix 3 – mekanizmi 2	/124
Figura 4.68 Deformimet totale - Mix 2 – mekanizmi 2	/125

Figura 4.69 Deformimet totale - Mix 4 – mekanizmi 2	/125
Figura 4.70 Deformimet totale - Mix 6 – mekanizmi 2	/126
Figura 5.1 Soliditeti në shtypje Mix 1 – Mix 2, për mosha të ndryshme	/130
Figura 5.2 Soliditeti në shtypje Mix 1 – Mix 2, për moshë të njëjtë	/131
Figura 5.3 Ndryshimi i soliditeti në shtypje Mix 1 – Mix 2 në përqindje	/131
Figura 5.4 Soliditeti në shtypje Mix 3 – Mix 4, për mosha të ndryshme	/133
Figura 5.5 Soliditeti në shtypje Mix 3 – Mix 4, për moshë të njëjtë	/134
Figura 5.6 Ndryshimi i soliditeti në shtypje Mix 3 – Mix 4 në përqindje	/134
Figura 5.7 Soliditeti në shtypje Mix 5 – Mix 6, për mosha të ndryshme	/136
Figura 5.8 Soliditeti në shtypje Mix 5 – Mix 6, për moshë të njëjtë	/137
Figura 5.9 Ndryshimi i soliditetit në shtypje Mix 5 – Mix 6 në përqindje	/137
Figura 5.10 Soliditeti në shtypje Mix 1 - Mix 3 - Mix 5, gjatë moshave të ndryshme	/138
Figura 5.11 Soliditeti në shtypje Mix 2 - Mix 4 - Mix 6, gjatë moshave të ndryshme	/138
Figura 5.12 Soliditeti në shtypje Mix 1 – Mix 2- Mix 3 – Mix 4- Mix 5 – Mix 6	/139
Figura 5.13 Soliditeti në tërheqje me çarje Mix 1 – Mix 2, gjatë moshave 28 dhe 90 ditë	/140
Figura 5.14 Ndryshimi i soliditetit në tërheqje me çarje Mix 1 – Mix 2 në përqindje	/141
Figura 5.15 Soliditeti në tërheqje me çarje Mix 3 – Mix 4, gjatë moshave 28 dhe 90 ditë	/142
Figura 5.16 Ndryshimi i soliditeti në tërheqje me çarje Mix 3 – Mix 4 në përqindje	/142
Figura 5.17 Soliditeti në tërheqje me çarje Mix 5 – Mix 6, gjatë moshave 28 dhe 90 ditë	/143
Figura 5.18 Ndryshimi i soliditeti në tërheqje me çarje Mix 5 – Mix 6 në përqindje	/144
Figura 5.19 Soliditeti në tërheqje me lakim Mix 1 – Mix 2	/145
Figura 5.20 Ndryshimi i soliditetit në tërheqje me lakim Mix 1 – Mix 2 në përqindje	/145
Figura 5.21 Soliditeti në tërheqje me lakim Mix 3 – Mix 4	/146
Figura 5.22 Ndryshimi i soliditetit në tërheqje me lakim Mix 3 – Mix 4 në përqindje	/147
Figura 5.23 Soliditeti në tërheqje me lakim Mix 5 – Mix 6	/148
Figura 5.24 Ndryshimi i soliditetit në tërheqje me lakim Mix 5 – Mix 6 në përqindje	/148
Figura 5.25 Moduli i Elasticitetit Mix 1 – Mix 2	/149
Figura 5.26 Moduli i Elasticitetit Mix 3 – Mix 4	/150
Figura 5.27 Moduli i Elasticitetit Mix 5 – Mix 6	/151
Figura 5.28 Ujë-përshkueshmëria Mix 1 – Mix 2	/153
Figura 5.29 Ujë-përshkueshmëria Mix 1 – Mix 2 në përqindje	/153
Figura 5.30 Ujë-përshkueshmëria Mix 3 – Mix 4	/154
Figura 5.31 Ujë-përshkueshmëria Mix 3 – Mix 4 në përqindje	/155
Figura 5.32 Ujë-përshkueshmëria Mix 5 – Mix 6	/156
Figura 5.33 Ujë-përshkueshmëria Mix 5 – Mix 6 në përqindje	/156
Figura 5.34 Deformimet nga tkurrja Mix 1 – Mix 2	/161
Figura 5.35 Tkurrja Mix 1 – Mix 2 në përqindje	/161
Figura 5.36 Deformimet nga tkurrja Mix 3 – Mix 4	/162
Figura 5.37 Tkurrja Mix 3 – Mix 4 në përqindje	/162
Figura 5.38 Tkurrja Mix 5 – Mix 6	/163
Figura 5.39 Tkurrja Mix 5 – Mix 6 në përqindje	/163
Figura 5.40 Deformimet nga tkurrja Mix 1 – Mix 3 – Mix 5	/164
Figura 5.41 Deformimet nga tkurrja Mix 2 – Mix 4 – Mix 6	/164
Figura 5.42 Deformimet totale Mix 1 – Mix 2	/165
Figura 5.43 Deformkoha plus tkurrjet Mix 1 – Mix 2	/165
Figura 5.44 Deformkoha Mix 1 – Mix 2	/166

Figura 5.45 Koeficienti i deformkohës Mix 1 – Mix 2 /166
 Figura 5.46 Deformimet totale Mix 3 – Mix 4 /167
 Figura 5.47 Deformkoha plus tkurrjet Mix 3 – Mix 4 /167
 Figura 5.48 Deformkoha Mix 3 – Mix 4 /168
 Figura 5.49 Koeficienti i deformkohës Mix 3 – Mix 4 /169
 Figura 5.50 Deformimet totale Mix 5 – Mix 6 /169
 Figura 5.51 Deformkoha plus tkurrjet Mix 5 – Mix 6 /169
 Figura 5.52 Deformkoha Mix 5 – Mix 6 /170
 Figura 5.53 Koeficienti i deformkohës Mix 5 – Mix 6 /170
 Figura 5.44 Deformimet totale nga deformkoha Mix 1 – Mix 3 – Mix 5 /171
 Figura 5.55 Deformimet totale nga deformkoha Mix 2 – Mix 4 – Mix 6 /172
 Figura 5.56 Koeficienti i deformkohës Mix 1 – Mix 3 – Mix 5 /172
 Figura 5.57 Koeficienti i deformkohës Mix 2 – Mix 4 – Mix 6 /173
 Figura 5.58 Deformimet nga tkurrja Mix 1: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /174
 Figura 5.59 Deformimet nga tkurrja Mix 2: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /174
 Figura 5.60 Deformimet nga tkurrja Mix 1 - Mix 2: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /175
 Figura 5.61 Deformimet nga tkurrja Mix 3: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /175
 Figura 5.62 Deformimet nga tkurrja Mix 4: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /176
 Figura 5.63 Deformimet nga tkurrja Mix 3 - Mix 4: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /176
 Figura 5.64 Deformimet nga tkurrja Mix 5: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /177
 Figura 5.65 Deformimet nga tkurrja Mix 6: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /177
 Figura 5.66 Deformimet nga tkurrja Mix 5 - Mix 6: cilindrike - prizmatike 600 – prizmatike 400 /178
 Figura 5.67 Deformimet totale për Mix 2- Mix 4 – Mix 6 – Mix 3 – mekanizmi 2 /180
 Figura 5.68. Krahاسimi i kostos për klasë të njëjtë në përqindje /183
 Figura 5.69. Krahاسimi i kostos së prodhimit të 50000m³ në vit /184
 Figura 5.70. Ndikimi i i Hirit të Tecit në koston e prodhimit të betonit për 50000m³/vit /184

Lista e tabelave

Tabela 0.1. Sasitë e hirit, si produkt i punës në termocentralet e Kosovës	/14
Tabela 0.2 - Qymyri për prodhimin e energjisë elektrike	/14
Tabela 0.3 Analizat kimike të Hirit të Tecit	/15
Tabela 2.1 Faktorët që ndikojnë në deformkohë dhe tkurrje të betonit	/27
Tabela 2.2. Efektet e tipeve të agregatit në modulën e elasticitetit	/40
Tabela 3.1 Forma dhe sasia e mostrave për eksperiment	/48
Tabela 3.2 Rezultatet nga testi laboratorik i çimentos t=2 ditë	/49
Tabela 3.3 Rezultatet nga testi laboratorik i çimentos t=7 ditë	/50
Tabela 3.4 Rezultatet nga testi laboratorik i çimentos t=28 ditë	/50
Tabela 3.5 Komponentet përbërëse të betonit Mix 1	/52
Tabela 3.6 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 1	/52
Tabela 3.7 Komponentet përbërëse të betonit Mix 2	/53
Tabela 3.8 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 2	/53
Tabela 3.9 Komponentet përbërëse të betonit Mix 3	/54
Tabela 3.10 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 3	/54
Tabela 3.11 Komponentet përbërëse të betonit Mix 4	/55
Tabela 3.12 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 4	/55
Tabela 3.13 Komponentet përbërëse të betonit Mix 5	/56
Tabela 3.14 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 5	/56
Tabela 3.15 Komponentet përbërëse të betonit Mix 6	/57
Tabela 3.16 Sasia e agregatit në përqindje për Mix 6	/57
Tabela 3.17 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 1), kallëpet kubike	/61
Tabela 3.18 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 1), kallëpet cilindrike	/61
Tabela 3.19 Konsistenca (Mix 1)	/61
Tabela 3.20 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 2), kallëpet kubike	/62
Tabela 3.21 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 2), kallëpet cilindrike	/62
Tabela 3.22 Konsistenca (Mix 2)	/62
Tabela 3.23 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 3), kallëpet kubike	/63
Tabela 3.24 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 3), kallëpet cilindrike	/63
Tabela 3.25 Konsistenca (Mix 1)	/63
Tabela 3.26 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 4), kallëpet kubike	/64
Tabela 3.27 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 4), kallëpet cilindrike	/64
Tabela 3.28 Konsistenca (Mix 4)	/64
Tabela 3.29 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 5), kallëpet kubike	/65

Tabela 3.30 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 5), kallëpet cilindrike	/65
Tabela 3.31 Konsistenca (Mix 5)	/65
Tabela 3.32 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 6), kallëpet kubike	/66
Tabela 3.33 Masa e betonit në gjendje të njomë, (Mix 6), kallëpet cilindrike	/66
Tabela 3.34 Konsistenca (Mix 6)	/66
Tabela 4.1 Soliditeti në shtypje - Mix 1	/73
Tabela 4.2 Soliditeti në shtypje - Mix 2	/74
Tabela 4.3 Soliditeti në shtypje - Mix 3	/76
Tabela 4.4 Soliditeti në shtypje - Mix 4	/77
Tabela 4.5 Soliditeti në shtypje - Mix 5	/78
Tabela 4.6 Soliditeti në shtypje - Mix 6	/80
Tabela 4.7 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 1	/81
Tabela 4.8 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 2	/82
Tabela 4.9 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 3	/83
Tabela 4.10 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 4	/84
Tabela 4.11 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 5	/85
Tabela 4.12 Soliditeti në tërheqje me çarje - Mix 6	/86
Tabela 4.13 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 1	/88
Tabela 4.14 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 2	/89
Tabela 4.15 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 3	/90
Tabela 4.16 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 4	/91
Tabela 4.17 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 5	/92
Tabela 4.18 Soliditeti në tërheqje me lakim - Mix 6	/93
Tabela 4.19 Ujë-përshkueshmëria - Mix 1	/94
Tabela 4.20 Ujë-përshkueshmëria - Mix 2	/95
Tabela 4.21 Ujë-përshkueshmëria - Mix 3	/96
Tabela 4.22 Ujë-përshkueshmëria - Mix 4	/97
Tabela 4.23 Ujë-përshkueshmëria - Mix 5	/98
Tabela 4.24 Ujë-përshkueshmëria - Mix 6	/99
Tabela 5.1 Krahasimi Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/129
Tabela 5.2 Krahasimi Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/132
Tabela 5.3 Krahasimi Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/135
Tabela 5.4 Krahasimi Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/139
Tabela 5.5 Krahasimi Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/141
Tabela 5.6 Krahasimi Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/143
Tabela 5.7 Krahasimi Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/144
Tabela 5.8 Krahasimi Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/146

Tabela 5.9 Krahاسimi Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/147
Tabela 5.10 Krahاسimi Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/149
Tabela 5.11 Krahاسimi Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/150
Tabela 5.12 Krahاسimi Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/151
Tabela 5.13 Krahاسimi Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/152
Tabela 5.14 Krahاسimi Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/154
Tabela 5.15 Krahاسimi Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/155
Tabela 5.16 Krahاسimi i deformimeve për Mix 1 – Mix 2, i shprehur në përqindje	/157
Tabela 5.17 Krahاسimi i deformimeve për Mix 3 – Mix 4, i shprehur në përqindje	/158
Tabela 5.18 Krahاسimi deformimeve për Mix 5 – Mix 6, i shprehur në përqindje	/158
Tabela 5.19 Krahاسimi deformimeve për Mix 1 – Mix 3 - Mix 5	/159
Tabela 5.20 Krahاسimi deformimeve për Mix 2 – Mix 4 - Mix 6	/160
Tabela 5.21. Sasitë e hirit, si produkt i punës në termocentralet e Kosovës	/180
Tabela 5.22. Kostoja për Mix 1	/181
Tabela 5.23. Kostoja për Mix 2	/181
Tabela 5.24. Kostoja për Mix 3	/181
Tabela 5.25. Kostoja për Mix 4	/181
Tabela 5.26. Kostoja për Mix 5	/182
Tabela 5.27. Kostoja për Mix 6	/182
Tabela 5.28. Krahاسimi i koston në %	/182
Tabela 5.29. Krahاسimi i koston në € për prodhimin e 50000 m ³ /vit	/183
Tabela 5.30. Llogaritja e kursimeve Euro (€)	/185
Tabela 5.31. Estimated Cost Savings to State DOTs of Using Fly Ash (FA) Concrete (\$ Millions)	/185

Parathënie

Nisur nga fakti se në Kosovë pothuajse e tërë energjia elektrike (97%) prodhohet nga djegia e thëngjillit dhe vetëm 3% nga hidrocentralet¹, kuptohet se nga djegia e qymyreve në Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” fitohet sasi jashtëzakonisht e madhe e hirit që deponohet. Sasia e përgjithshme e hirit është rreth 40 milion tonelata, në të dy deponitë². Për ilustrim, në *Tab. 0.1* tregohet sasia e hirit, si produkt i punës në termocentralet e Kosovës².

Tabela 0.1. Sasitë e hirit, si produkt i punës në termocentralet e Kosovës²

Prodhimi	Viti Njësia	2005	2006	2007	2008
	t/y	232618.7	321577	438272.32	376179
TC Kosova A	t/MW	0.293	0.3109	0.315	0.27
	t/y	820362.7	726559.4	723183.10	784992
TC Kosova B	t/MW	0.232	0.227	0.219	0.21
	t/y	1052981.4	1048136.4	1161455.42	1161171
Shuma (A+B)	t/MW	0.2409	0.24241	0.267	0.24
	t/y				

Për prodhimin e energjisë elektrike qymyret përdoren edhe në shumë vende të botës. Pesë përdoruesit më të mëdhenj (76% të totalit global të përdorimit janë SHBA, Kina, India, Rusia dhe Japonia³).

Tabela 0.2 - Qymyri për prodhimin e energjisë elektrike⁴

Qymyri për prodhimin e energjisë elektrike		
Afrika e Jugut 93%	Polonia 87%	Kina 79%
Australia 78%	Kazakistan 75%	India 68%
Izraeli 58%	Rep. Çeke 51%	Marok 51%
Greqia 54%	USA 45%	Gjermania 41%

¹ [34]

² [32]

³ [35]

⁴ [36]

Në prodhimin e betoneve hiri fluturues (angl. Fly Ash), si produkt që fitohet nga djegia e qymyreve, si përbërës mund të zëvendësoj një pjesë të çimentos Portland.

Sipas ASTM C618, hiri fluturues klasifikohet në dy klasa: F dhe C. Kriteri kryesor i klasifikimit është kërkesa kimike. Për klasën F nevojitet që

$\text{SiO}_2 + \text{Al}_2\text{O}_3 + \text{Fe}_2\text{O}_3 \geq 70\%$ ndërsaq për klasën C $\text{SiO}_2 + \text{Al}_2\text{O}_3 + \text{Fe}_2\text{O}_3 \geq 50\%$.

Një nga aspektet më të rëndësishme të përdorimit të Hirit të Tecit në beton është dëshmia se, në përgjithësi, përdorimi i hirit, padyshim, përmirëson vetitë e betonit të njomë (freskët)¹. Duke zëvendësuar një pjesë të çimentos Portland me Hira Teci zvogëlohet, në radhë të parë, prodhimi i çimentos, me ç'rast reduktohet emetimi i CO₂ në atmosferë. Përmendim këtu faktin se për ton të prodhuar të çimentos lirohet një ton CO₂.

Mbështetur në këto të dhëna dhe në analizat kryera mbi vetitë e Hirit të Tecit të mbetur nga djegia e qymyreve në Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” (me theks TC “Kosova B”) ka lindur ideja e temë së disertacionit.

Analizat kimike për Hirin e Tecit (“Kosova B”), janë kryera në Laboratorin ZAG, Lubjanë, Slloveni.

Tabela 0.3 Analizat kimike të Hirit të Tecit

Përbërësit	Sasia %
SiO ₂	29,7
Al ₂ O ₂	10,65
Fe ₂ O ₃	6,18
CaO	32,92
MgO	5,93
SO ₃	9,98
Na ₂ O	0,74
K ₂ O	0,61

Përbërja kimike e Hirit të Tecit në masë të madhe favorizon përdorimin e tij në prodhimin e betonit, si zëvendësim i pjesshëm i çimentos Portland.

Si rrjedhim i kësaj dhe duke pasur parasysh çështjet ekologjiko mjedisore, ekonomike si dhe ato shkencore, ky studim është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Standardeve Evropiane për beton EN 206-1 dhe për hiri fluturues EN 450-1 dhe EN 450-2.

¹ [21]

Kapitulli 1

Hyrje

“...Si betoni i mirë dhe betoni i keq, gjithmonë përgatiten me çimento, agregat, ujë dhe shtesa; ndryshimi ndërmjet një produkti të mirë dhe një produkti të dobët qëndron në zgjedhjen korrekte ose jo të përbërësve dhe në raportet korrekte të tyre...”

A. Neville

1.Hyrje

Siç u tha në parathënie, Hirat e Tecit janë mbetje që fitohen nga djegia e qymyreve në termocentrale. Në Kosovë hirat fluturuesë (Fly Ash) janë me shumicë. Qëllimi i këtij studimi është për t'i paraprirë përdorimit të tyre për prodhimin e betoneve dhe përcaktimin e raporteve optimalë të përzirjes: çimento/pluhuri fluturues, aggregateve, në varësi të raportit u/ç. Andaj, në kërkimet që janë kryer, *Betoneve me Hira Teci* i është kushtuar rëndësi themelore.

Për të vendosur dhe zgjedhur tematikën e këtij studimi kërkimor, ka qenë e nevojshme të ndërmerret një sondazh paraprak për të parë nëse karakteristikat teknike, përfshirë vetitë kimike, fizike e mekanike, janë ose jo të përshtatshme për t'u përdorur në përzierjet e betonit. Për të analizuar ndikimin e Hirit të Tecit në rezistencën në shtypje të betonit janë bërë disa teste paraprake në shkallë laboratorike (në Laboratorin “Vëllezërit e Bashkuar” – Prizren, Kosovë), me hargjime të ndryshme të pluhurit të tecit në raport me çimenton dhe materialet e tjera përbërëse. Me këtë rast ishte mjaft e nevojshme të detajohen çështjet kryesore që kanë të bëjnë me projektimin, prodhimin dhe përdorimin e betoneve me hira teci.



Fragmente nga studimi laboratorik i përgatitjes së përzierjeve provë

Bazuar në planin kërkimor të disertacionit, qëllimi kryesor në këtë studim është caktimi i nivelit (%) të ndikimit të Hirit të Tecit, si komponent përbërës në vetitë e çimentos/betonit. Për këtë arsye janë hulumtuar karakteristikat mekanike (soliditeti në shtypje, soliditeti në prerje dhe moduli i elasticitetit) dhe ato deformuese (deformimet nga tkurrja dhe deformimet nga deformkoha). Për të shqyrtuar ndryshimin e karakteristikave mekanike në funksion të kohës dhe mjedisit, për klasat e betonit C25/30; C30/37 dhe C40/50, janë përgatitur mostra me formë cilindrike 100x200 [mm']; 150x300 [mm']; kubike 150/150/150 [mm'] dhe prizmatike 100x100x400 [mm']; 150x150x600 [mm']. Për realizimin e testeve janë shfrytëzuar labororet e FNA, Prishtinë; Proing, Prishtinë, Albconsult 2 sh.p.k., Tiranë, IBMS, Prishtinë dhe hapësira e veçantë e Kompanisë OLSKA ING sh.p.k, Prishtinë, ku temperatura dhe lagështia relative kanë qenë relativisht konstante.



Hapësira për eksperiment



Mbushja e kallëpeve për një Mix



Vendosja në presë dhe aplikimi i forcës




Ekzaminimi i soliditetit në shtypje



Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje me çarje



Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë




*Ekzaminimi i soliditetit në tërheqje
me lakim*



Ekzaminimi i modulit të elasticitetit





Mekanizmi për matjen e deformimeve nga deformkoha

Siç dihet, sot ka një përvojë të gjërë në përdorimin e Hirave të Tecit në përzierjet e betonit, por për ato që prodhohen në Kosovë ky është studimi i parë që ndërmerret në këtë fushë. Andaj, duke patur parasysh sasinë e madhe të Hirave të Tecit, që rezultojnë si mbetje nga djegia e qymyreve në termocentralet në Kosovë, si dhe mbështetur në Standardet Evropiane EN206 për betonin dhe EN450-1, EN450-2, për hirat fluturuesë (Fly Ash), është parë me interes të veçantë të ndërmerret ky studim me synimin kryesor në kërkime shkencore, përfshirë edhe ato të aspektit ekonomik.

Mbështetur në faktin se Hiri i Tecit është material kokërrimët, nga eksperimentet është pritur që deformimet nga tkurrja, për shkak të zvogëlimit të sasisë së çimentos, të zvogëlohen, sidomos, në fazën fillestare, me ç'rast edhe do të mund të eliminohen plasaritjet që lindin si pasojë e nxehtësisë së hidratimit të çimentos.

Në paraqitjen e saj tërësore materiali i disertacionit është trajtuar në shtatë kapituj: **Kapitulli i parë:** Hyrje; **Kapitulli i dytë:** Njohuritë nga literatura; **Kapitulli i tretë:** Hulumtimet laboratorike; **Kapitulli i katërt:** Përmbledhja e rezultateve; **Kapitulli i pestë:** Diskutimi i rezultateve; **Kapitulli i gjashtë:** Përmbledhje, konkluzione dhe rekomandime; **Kapitulli i shtatë:** Referencat e shfrytëzuara.

Në kapitullin e dytë të punimit janë hedhur njohuritë e fituara nga literatura. Deformimet që shfaqen në beton përbëhen prej deformimeve nga tkurrja, që ndodhin si rezultat i tharjes; deformimeve fillestare elastike, që ndodhin në momentin e aplikimit të forcës dhe nga deformkoha, që ndodhin kur ngarkesa është e qëndrueshme me kalimin e kohës. Deformkoha paraqet deformimet e materialit nën

veprimin e ngarkesë së qëndrueshme me kalimin e kohës. Deformimi fillestar, për shkak të ngarkesës, është deformim elastik, ndërsa deformimi shtesë është i varur nga ngarkesa e qëndrueshme në kohë dhe paraqet deformkohën. Deformkoha nuk mund të caktohet si e vetme. Përcaktimi i saj bëhet duke i zbritur deformimin nga tkurrja dhe deformimin elastik. Tkurrja, gjithashtu, është e varur nga koha dhe paraqet shkurtimin e betonit, për shkak të humbjes së lagështisë që ndodh në faza të ndryshme të moshës së betonit. Tkurrja nuk varet nga ngarkesa. Në këtë pjesë të punimit tregohen edhe kriteret për llogaritjen e tkurrjes, deformkohës dhe modulit të elasticitetit, sipas EC-2; ACI-209 dhe CEB-FIP.

Pjesa e tretë paraqet procedurën e përdorur gjatë hulumtimeve laboratorike, duke filluar nga hapësira ku janë bërë eksperimentet, për të vazhduar mbi materialet e përdorura për punimin e mostrave, recepturën e betonit Mix Design, pajisjet për matje, ekzaminimin e mostrave dhe mënyrën e ngarkimit të tyre.

- Programi eksperimental përfshinë një numër të konsiderueshëm të mostrave dhe atë: kubike 150x150x150 (162 copë), cilindrike 100x200 (42 copë) dhe 150x300 (72 copë) si dhe prizmatike 100x100x400 (18 copë) dhe 150x150x600 [mm] (18 copë).

- Materialet e përdorura për realizim të eksperimentit: çimento CEM I 52,5 – SHARR CEM Elez Han, Kosovë; agregati i thyer në katër fraksione - VËLLEZËRIT E BASHKUAR – Prizren, Kosovë; hiri nga termocentrali ‘Kosova B’ – Obiliq, Kosovë; aditivi – TTK, Slloveni dhe uji i pijshëm. Përgatitja e brumit të betonit dhe mbushja e kallëpeve është realizuar në vend.

- Për realizimin e eksperimentit janë përgatitur 6 (gjashtë) përzierje të ndryshme (Mix Design): C25/30 Etalon; C25/30 me 25% Hira Teci; C30/37 Etalon; C30/37 me 25% Hira Teci; C40/50 Etalon; C40/50 me 25% Hira Teci.

- Në mostrat cilindrike dhe prizmatike janë bërë matjet e deformimeve nga tkurrja dhe deformimeve nga deformkoha.

- Soliditeti në shtypje, për të gjitha recepturat, me dimensione të kubëzave 150/150/150 [mm], është ekzaminuar sipas Stardadit SK EN 12390-3:2000.

- Soliditeti në tërheqje me çarje është ekzaminuar sipas Standardit SK EN 12390-6:2000, dimensionit i kubëzave $150/150/150$ [mm].
 - Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë është bërë në pajisjen speciale, ku mostrat me dimensione $150/150/150$ kanë qëndruar 72 orë nën presion të ujit. Pastaj, pas çarjes, është bërë matja e depërtueshmërisë së ujit sipas Standardit SK EN 12390-8:2000.
 - Soliditeti në tërheqje me lakim është ekzaminuar, po ashtu, sipas Standardit SK EN 12390-5:2000. Dimensionit i prizmeve $150/150/600$ [mm].
 - Moduli i Elasticitetit është ekzaminuar sipas standardit ASTM C 469; dimensionit i cilindrave $150/300$ [mm].
 - Matjet e deformimeve nga tkurrja, në cilindrat $d/h=100/200$ [mm], nga dy mostra për gjashtë Mix-et (Mix 1 - C25/30 etalon, Mix 2 – C25/30 me 25% Hira Teci, Mix 3 – C30/37 etalon, Mix 4 – C30/37 me 25% Hira Teci, Mix 5 – C40/50 etalon, Mix 6 – C40/50 me 25% Hira Teci), janë bërë nga $t_0=10$ ditë. Matjet, po ashtu, janë bërë edhe në mostrat prizmatike me dimensione $a/b/l=100/100/400$ [mm], nga tri mostra për secilin Mix si dhe në ato me $a/b/l=150/150/600$ [mm], nga dy mostra për Mix.
 - Matjet e deformimeve nga deformkoha, në cilindrat $d/h=100/200$ [mm], nga dy mostra për gjashtë Mix-et, janë bërë nga $t_0=10$ ditë.
 - Për realizimin e forcës konstante, mostrat gjatë tërë kohës kanë qenë të vendosura në rama speciale.
- Kapitulli i katërt përfshin Përmbledhjen e rezultateve eksperimentale, të karakteristikave mekanike dhe reologjike të mostrave të ekzaminuara. Rezultatet e fituara, për të gjitha llojet e testimeve, nga koha $t=2$ ditë, janë dhënë në mënyrë tabelare dhe përmes diagrameve.*
- Soliditeti në shtypje, për të gjitha recepturat, është analizuar në mostra kubike, dimensionet e të cilave janë $150 \times 150 \times 150$ [mm]. Meqë ato mostra kanë dy faqe të rrafshëta nuk ka qenë e nevojshme që, para ekzaminimit, të bëhet rrafshimi i

tyre, siç rëndom ndodh te mostrat cilindrike. Krahasimi është bërë në mes të klasave të njëjta, njëra me etalon dhe tjetra me shtesa Hira Teci 25%: C 25/30 Etalon; C 25/30 me 25% Hira Teci; C 30/37 Etalon; C 30/37 me 25% Hira Teci; C 40/50 Etalon; C 40/50 me 25% Hira Teci.

- Soliditeti në tërheqje me çarje, për të gjitha recepturat, është analizuar, po ashtu, në mostra kubike $150 \times 150 \times 150$ [mm]. Krahasimi është bërë ndërmjet klasave të njëjta, njëra me etalon dhe tjetra me shtesa Hira Teci 25%. Soliditeti në tërheqje me çarje është ekzaminuar për vjetërsinë 28 dhe 90 ditë.

- Për të gjitha recepturat, soliditeti në tërheqje nga përkulja është analizuar në mostra prizmatike $150 \times 150 \times 600$ [mm]. Edhe në këtë rast, krahasimi është bërë ndërmjet klasave të njëjta, njëra me etalon dhe tjetra me shtesa Hira Teci 25%. Soliditeti në tërheqje me lakim është ekzaminuar për vjetërsinë >28 ditë.

- Përcaktimi i ujë-përshkueshmërisë, për të gjitha recepturat, është analizuar në mostra kubike $150 \times 150 \times 150$ [mm]. Krahasimi është bërë ndërmjet klasave të njëjta. Janë ekzaminuar për vjetërsinë 28 dhe 90 ditë.

- Për të analizuar deformimet nga tkurja dhe deformkoha, për secilin Mix, janë marrë nga katër mostra cilindrike $100/200$ [mm]. Për matje të deformimeve atyre i janë vendosur nga katër pika.

- Analiza e deformimeve në funksion të kohës është synimi kryesor i këtij hulumtimi. Për këtë arsye kujdes i veçantë i është kushtuar përgatitjes së hapësirës për eksperiment, kushteve të ambientit (lagështisë relative dhe temperaturës).

Në praktikën inxhinierike, siç dihet, më të njohura janë:

- (1) Deformimet në funksion të kohës, të cilat ndodhin në elementet e pa ngarkuara të betonit, quhen deformime të tkurrjes. Në këtë rast, në elementet e betonit, vjen deri të zvogëlimi i vëllimit;

- (2) Deformimet nga deformkoha, që ndodhin pas veprimit të ngarkesës konstante. Pas paraqitjes së deformimit fillestar, që quhet deformim elastik, deformimet vazhdojnë të rriten.

- Matjet e tkurjeve janë bërë edhe në prizmat me dimensione $100 \times 100 \times 400$ dhe $150 \times 150 \times 600$ [mm]. Ato janë krahasuar mes veti dhe me tkurjet në cilindrat 100×200 [mm].
- Të gjitha rezultatet e fituara, për tkurje dhe deformkohë, janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike, ndaras për çdo Mix.

Pjesa më e rëndësishme e punimit të disertacionit konsiderohet *kapitulli i pestë: Diskutimi i rezultateve*. Diskutimi i rezultateve laboratorike është paraqitur përmes diagrameve dhe në mënyrë tabelare, me ndryshimet në përqindje. Krahasimet e rezultateve të fituara janë bërë për: soliditetin në shtypje, soliditetin në tërheqje me çarje, soliditetin në tërheqje me lakim, ujë-përshkueshmërinë, modulin e elasticitetit, deformimet nga tkurja dhe deformimet nga deformkoha.

Kapitulli i gjashtë përmban përmbledhjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij punimi. Aty, në mënyrë të sintetizuar, evidentohen rezultatet kryesore të arritura me këtë punim.

Kapitulli i shtatë paraqet një përmbledhje të literaturës së shfrytëzuar gjatë hartimit të punimit. Janë përfshirë publikime më të rëndësishme për fushën.

Në fund, autori i punimit do të shprehte respekt e mirënjohje të madhe, në radhë të parë, për udhëheqësin shkencor, Prof. asoc. Dr. Fisnik Kadiu, si dhe falënderon të gjithë ata që me vërejtjet, sugjerimet dhe vlerësimet që i kanë bërë materialit, ndihmuar në përgatitjen finale të këtij punimi.

Me obligimin e natyrshëm që shumëkush, besoj, ndjen pas përfundimit të punimit, do të dëshiroja që, të paktën, të përmend, këtu, durimin që familja ime tregoi gjatë kësaj kohe.

Kapitulli 2

Njohuritë nga literatura

2. Njohuritë nga literatura

Në këtë pjesë të punimit janë hedhur njohuritë e fituara nga literatura. Janë paraqitur (I) disa të dhëna mbi deformimet në beton në funksion të kohës si dhe (II) kriteret për llogaritjen e deformimeve nga tkurrja, deformimeve nga deformkoha e moduli i elasticitetit sipas EC2; ACI-209 dhe CEB-FIP.

I.2. Disa të dhëna mbi deformimet në beton në funksion të kohës (deformkoha dhe tkurrjet)

I.2.1 Të përgjithshme

Deformimet që ndodhin në beton përbëhen prej deformimeve nga tkurrja, që ndodhin si rezultat i tharjes; deformimeve fillestare elastike, që ndodhin në momentin e aplikimit të forcës dhe nga deformkoha, që ndodhin kur ngarkesa është e qëndrueshme me kalimin e kohës.

Deformkoha paraqet deformimet e materialit nën veprimin e ngarkesë së qëndrueshme me kalimin e kohës. Deformimi fillestar, për shkak të ngarkesës, është deformim elastik, ndërsa deformimi shtesë është i varur nga ngarkesa e qëndrueshme në kohë dhe paraqet deformkohën. Deformkoha nuk mund të caktohet si e vetme, përcaktimi bëhet duke i zbritur deformimin nga tkurrja dhe deformimin elastik.

Tkurrja, gjithashtu, është e varur nga koha dhe paraqet shkurtimin e betonit, për shkak të humbjes së lagështisë që ndodh në faza të ndryshme të moshës së betonit. Tkurrja nuk varet nga ngarkesa.

Moduli i elasticitetit përcaktohet si raport sforcim – deformim, përkatësisht në kufirin proporcional. Lakorja sforcim – deformim e betonit është jo-lineare, kryesisht për shkak të ekzistencës së deformkohës edhe në fazën fillestare të ngarkimit. Ndarja mes deformimit të menjëhershëm elastik dhe deformimit në fillim të deformkohës është e vështirë. Për qëllime praktike, dallimi arbitrar është bërë me deformimin fillestar që rezulton nga zbatimi forcës projektuese dhe konsiderohet si deformim

I.2.3 Deformkoha dhe tkurrja në beton

I.2.3.1 Faktorët që ndikojnë në deformkohë dhe tkurrje

Faktorët që ndikojnë në deformkohë dhe tkurrje të betonit klasifikohen si faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm.

Faktorët e brendshëm janë karakteristikat e materialeve që janë përdorur, p.sh. përzierja, përbërja, cilësitë e materialit, etj.

Ndikimet e jashtme i referohen faktorëve të cilët mund të ndikojnë pasi që betoni është hedhur në vepër (si ndikimi i kushteve të mjedisit në strukturën e betonit) (Bazant, 1988).

Faktorët për deformkohë dhe tkurrje janë treguar në *Tabelën 2.1*.

Tabela 2.1 Faktorët që ndikojnë në deformkohë dhe tkurrje të betonit

Faktorët	Faktorët që ndikojnë në:	
	Deformkoha	Tkurrja
E brendshëm	Agregati – madhësia e kokrrës dhe cilësitë mekanike	Agregati – madhësia e kokrrës dhe cilësitë mekanike
	Lloji i çimentos	Lloji i çimentos
	Raporti ujë-çimento	Raporti ujë-çimento
	Klasa e Betonit	Klasa e Betonit
E jashtëm	Kushtet e mirëmbajtjes	Kushtet e mirëmbajtjes
	Temperatura dhe lagështia	Temperatura dhe lagështia
	Mosha në ngarkim	Mosha kur fillon tharja
	Intensiteti forcës	---

I.2.3.2 Tkurrja e betonit

Tkurrja paraqet zvogëlimin e vëllimit të betonit në funksion të kohës, d.m.th. ndryshohet vëllimi i betonit dhe shkurtohen përmasat lineare të elementit kur nuk i nënshtrohet ngarkesës. Bymimi shoqërohet me rritjen e vëllimit të betonit dhe shkatohet si rezultat i prezencës më të madhe të ujit ose mjedisit të ngopur me lagështi. Të dy dukuritë shprehen në njësi [mm/mm], kur matjet kryhen në ambientet me kushte normale të lagështisë relative (RH %) dhe temperaturë (T °C). Në mes këtyre dy dukurive, më me rëndësi është tkurrja, meqë është një ndër shkaktarët e plasaritjeve të strukturave.




Figura 2.2. Tkurrja e betonit¹

I.2.3.2.1 Tkurrja gjatë tharjes

Si pasojë e ndërrimit të lagështisë të gurit të çimentos, përkatësisht betonit, pas përfundimit të lidhjes, paraqitet tkurrja gjatë tharjes. Pra, tkurrja gjatë tharjes shkatohet në betonin e ngurtësuar.

¹[23]H.Sadiku




Figura 2.3. Lidhja ndërmjet pjesëmarrjes së ujit në betonin e njomë dhe tkurrjeve gjatë tharjes¹

I.2.3.2.2 Tkurrja plastike

Si shkaktar i avullimit të ujit në kohën e lidhjes së çimentos paraqitet tkurrja plastike. Me rastin e avullimit të ujit shfaqen shtypje negative në kapilarë. Kjo shtypje rritet përderisa arrihet niveli kur nuk ka më ujë në beton. Pas kësaj tkurrja plastike ndalet.

I.2.3.2.3 Faktorët e brendshëm: karakteristikat dhe sasia e çimentos së përdorur, sasia dhe granulometria e agregatit, sasia e ujit dhe sasia e armimit.

Betoni, i cili në përbërjen e tij ka agregat me kokrra më të mëdha dhe formë më të vrazhdë, ka deformime më të vogla të tkurrjes.

¹ [1] A.M.Neville




Figura 2.4. Ndikimi në tkurrje i raportit ujë/çimento dhe pjesëmarrja e agregatit¹

Sa më i lartë të jetë raporti ujë-çimento, aq më shumë shkaktohen tkurrje të mëdha, veçanërisht kur masës i shtohet ujë gjatë transportit apo para - gjatë vendosjes në pahi.

Çimentoja me lidhje të shpejtë, në raport me çimento normale, shkakton deformime më të mëdha të tkurrjes. Rritja e sasisë së çimentos rezulton me rritjen e tkurrjeve.

Aditivët mund të rrisin, të zvogëlojnë ose fare mos të ndikojnë në deformimet nga tkurrja.

Prania e armaturës zvogëlon tkurrjen.

¹ [1]A.M.Neville

I.2.3.2.4 Faktorët e jashtëm: temperatura, lagështia relative dhe mirëmbajtja e betonit.

Lagështia relative dhe temperatura janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e deformimeve nga tkurja në beton. Shpejtësia e tkurjes është më e vogël në ambient me lagështi relative më të madhe, ndërsa temperatura e kufizuar (e përshtatshme) sjell deri te stabilizimi i tkurjes.




Figura 2.5. Lidhja midis tkurjes dhe kohës për betonet e ruajtura në lagështi relative të ndryshme¹

Disa nga studiuesit supozojnë se mirëmbajtja e betonit pas vendosjes në pahë nuk ka ndikim në vlerën përfundimtare të deformimit të tkurjes (Carlson 1938), ndërsa të tjerët, si (Kligen 1960) konsiderojnë se kohëzgjatja e mirëmbajtjes redukton tkurrjen deri në 30%².

¹ [1] A.M.Neville

² [2] H.Sadiku

I.2.3.3 Deformkoha në beton

Deformkoha paraqet rritjen e sforcimeve në elementin e betonit nën veprimin e ngarkesës aksiale, në kohën t ($t > t_0$) dhe sforcim konstant $\sigma_c(t_0)$. Deformimet fillestare nën veprimin e ngarkesës paraqesin sforcimet elastike. Koeficienti i deformkohës nuk mund të caktohet drejtpërdrejt, por përcaktohet vetëm kur i zbritet sforcimi fillestar (elastik) dhe sforcimi i tkurrjes nga deformimi total $\varepsilon_c(t)$, në kohën t . Mund të paraqiten si shumë e deformimeve të ndara:

$$\varepsilon_c(t) = \varepsilon_{cs}(t_0) + \varepsilon_{cc}(t) + \varepsilon_{cs}(t) + \varepsilon_{cT}(t)$$

ku:

$\varepsilon_c(t)$ deformimi total në beton në kohën (t)

$\varepsilon_{cs}(t_0)$ deformimet momentale, fillestare në beton gjatë ngarkimit (koha t_0)

$\varepsilon_{cc}(t)$ deformimet nga koha / deformkoha në kohën ($t > t_0$)

$\varepsilon_{cs}(t)$ deformimet e tkurrjes në kohën ($t > t_0$)

$\varepsilon_{cT}(t)$ deformimet nga ndryshimi i temperaturës

Për temperaturë konstante:

$$\varepsilon_c(t) = \varepsilon_{cs}(t_0) + \varepsilon_{cc}(t) + \varepsilon_{cs}(t)$$




Figura 2.6 Deformimet në beton në funksion të kohës

Në momentin e ngarkimit (sforcimit) në beton lajmërohet deformimi elastik. Për aq kohë sa ngarkesa është konstante në kohë, deformimet rriten me kalimin e kohës. Nëse ngarkesa largohet (nuk vepron në element) lindin deformimet kthyesë (të barabarta me vlerën e deformimeve elastike), e më pas tek deformimet kthyesë që varen nga koha. Përkrahë tyre në beton mbeten edhe deformimet e pa kthyeshme (të përhershme) . (Figura 2.7).




Figura 2.7. Deformimet në beton nga aplikimi i ngarkesës dhe pas largimit të saj¹

¹ [20] P.Kumar Mehta, Paulo J. M. Monteiro

I.2.3.3.1 Ndikimi nga faktorët e brendshëm në deformkohë

Betoni i cili tregon shkallë të lartë në tkurje, sipas rregullit, ka edhe deformkohë të lartë. Faktorët më të rëndësishëm, që ndikojnë në determinimin e zhvillimit dhe vlerës përfundimtare të deformimeve nga deformkoha, janë:

Edhe pse në kushte të ndryshme, agregati ka veti të deformkohës, për ngarkesa të zakonshme, në mënyrë restriktive, vepron ndaj deformimeve të deformkohës. Në deformkohë ndikojnë edhe përbërja mineralogjike-petrografike e agregatit, granulometria, kokrrat maksimale dhe format e tyre.




Figura 2.8. Deformkoha e betonit me përzierje të caktuar, me agregat të ndryshëm, ngarkuar në moshën 28 ditë dhe i ruajtur në temperaturë 21°C dhe lagështi relative 50%¹

¹ [1] A.M.Neville

Me rritjen e faktorit ujë-çimento rriten deformimet e deformkohës (Figura 2.9)




Figura 2.9. Koeficienti i deformkohës në varësi të faktorit ujë-çimento

Sasia e çimentos që përdoret ka ndikim të rëndësishëm. Sa më tepër që përdoret (në sasi), deformimet nga deformkoha do të jenë më të vogla.

Armatura redukton deformkohën.

Eksperimentalisht është treguar se me rritjen e dimensioneve të elementëve zvogëlohen deformimet nga deformkoha.

I.2.3.3.2 Ndikimi nga faktorët e jashtëm në deformkohë

Në ambient, me lagështi relative më të ulët, deformimet nga deformkoha rriten (Figura 2.10). Me rritjen e temperaturës, kryesisht, vjen deri te rritja e deformimeve nga deformkoha (Figura 2.11).




Figura 2.10. Ndikimi i lagështisë relative në koeficientin e deformkohës¹




Figura 2.11. Efekti i temperaturës së betonit në deformkohë²

Mund të supozohet se varësia **sforcim-deformim** është lineare kur intensiteti i ngarkesës së betonit është në nivelin 0,4 të soliditetit të betonit².

Në fig. 2.12 është paraqitur diagrami i koeficientit të deformkohës në funksion të nivelit të ngarkesës.

¹ [1] A.M.Neville

² [20] P.Kumar Mehta, Paulo J. M. Monteiro




Figura 2.12. Diagrami i koeficientit të deformkohës në funksion të nivelit të ngarkesës

II.2. Kriteret për llogaritje, sipas EC-2; ACI-209 dhe CEB-FIP

II.2.1 Moduli i Elasticitetit

II.2.1.1 Moduli i Elasticitetit, sipas EC2

Moduli i Elasticitetit, sipas Eurokod 2 (EC-2), është dhënë në klauzolën 3.1.3. Vlerat e rekomanduara janë dhënë për betone me peshë normale dhe agregat kuarci për modulën sekand të elasticitetit E_{cm} , ndërmjet vlerave $\sigma_c=0$ dhe $0,4f_{cm}$.

Kur përdoret agregati gëlqeror dhe ranor, moduli i elasticitetit të betonit duhet të reduktohet për 10%, respektivisht 30%. Për agregatin bazalt vlerat duhet të rriten për 20%.

